

Manual i testeve laboratorike



☎ 042-35 75 35
www.spitaliamerikan.com
pranë Spitalit Ushtarak - Laprakë, Tiranë







Parathënie

Gjatë një periudhe 2 vjeçare të punës në American Hospital, Departamenti i Labororit Klinik – biokimik, mikrobiologjik dhe patologjik ka kryer suksesshëm suportin laboratorik të pacientëve ambulatorë në parandalimin dhe diagnostikimin e patologjive të ndryshme si dhe aplikimin e protokolleve laboratorike pre - koronarografi për pacientët kardiakë, pre – kimioterapi për pacientët onkologjikë, ndjekjen pre dhe post-operatore të pacientëve të kardiokirurgjisë, kirurgjisë abdominale, kirurgjisë ortopedike, okulistike, ORL dhe të kirurgjisë plastike.

Pranë labororit tonë janë realizuar me sukses gjithashtu ekzaminimet e detajuara gjenetike, klinike dhe biokimike të pacientëve pre –transplant dhe monitorimi laboratorik frekuent i imunosupresorëve (ciklosporinë, takrolimus dhe sirolimus)

në këta pacientë pas transplantit. Ky monitorim realizohet për herë të parë në Shqipëri.

Nën asistencën e bankës së gjakut të spitalit universitar të Ankarasë, me fillimin e procedurave kirurgjikale, në klinikën tonë u aplikua ‘crossmatching’ për pajtueshmërinë e gjakut. Ky reaksion kryhet ndërmjet gjakut të donorit dhe pacientit për të minimizuar në maksimum reaksionin hemolitik që ndodh tek pacienti pas transfuzionimit me gjakun e donorit. Gjaku i donorit është jo vetëm izo-grup dhe izo-rhexus por tashmë dhe me një pajtueshmëri maksimale për nëngrupet, që realizohet me anë të kësaj procedure.

Qysh në fillimet e tij ky laborator u konceptua dhe ndërtua me teknologjinë më të fundit në fushën laboratorike totalisht

Lista e Departamenteve të American Hospital

Kardiologji
Kardiokirurgji
Kirurgji e Përgjithshme
Kirurgji Plastike
Neurologji
ORL
Psikologji
Psikiatri
Gastroenterologji
Ortopedi
Pediatri
Urologji
Nefrologji
Okulistikë
Hematologji
Onkologji
Mikrokirurgji
Obstetrike - Gjinekologji
Pneumologji
Alergologji
Reumatologji
Dermatologji
Imunologji
Endokrinologji
Radiologji e Avancuar
MR 1.5 Tesla
CT 64 detektorë
Shintigrafi
Mamografi
Densitometri e Kockës

automatike, të kompanive më të njohura Roche Diagnostics, Sysmex, Biomeriuex, Mindray , Sebia etj. Këto aparatura tërësisht automatike minimizojnë në maksimum gabimet që sjellin metodat e mëparshme manuale.

Bashkangjitur kësaj teknologjie është dhe paisja e këtij laborator me sistemin informatik laboratorik (LIS-laboratory information system) që shmang gabimet njerëzore në ngatërrimin e mostrave të gjakut të pacientëve dhe njëkohësisht në arshivimin e të gjithë rezultateve laboratorike të çdo pacienti .

Këto rezultate janë disponibël në çdo moment kur pacientit i nevojiten ato për informacion të gjëndjes së tij shëndetësore, për qëllime krahasuese të rezultateve laboratorike pre dhe post-terapeutike.

Pas gjithë punës dy vjeçare dhe gamës së gjerë të testeve laboratorike që ne ofrojmë, menduam që në mënyrë modeste t'ju ofrojmë një manual të testeve laboratorike më të përdorshme gjatë rutinës së punës. Gjithashtu ky manual përfshin edhe teste laboratorike specifike që do ju ndihmojnë në diagnostikimin e patologjive specifike apo të rralla, por dhe për diagnozën diferenciale mes patologjive të ndryshme ku laboratorit zë një vend specifik.

Ky manual është konceptuar në dy pjesë:

- pjesa e përgjithshme që do të përmbajë testet laboratorike më të përdorshme gjatë praktikës së përditshme mjekësore
- pjesa speciale që do të përmbajë teste laboratorike me specifike dhe më të detajuara për hulumtimin e patologjive të ndryshme.

Duke shpresuar dhe besuar se po ju ofrojmë një material të vlefshëm për punën tuaj të përditshme, mirëpresim sugjerimet tuaja për të përmirësuar punën tonë të përbashkët.

Procedurat laboratorike dhe shmangia e gabimeve të mundshme

Cilësia e kujdesit për pacientin, varet nga cilësia e të gjithë informacionit të mbledhur nga mjeku në mënyrë që të marrë më pas vendime në lidhje me të.

Ndërsa klinikistët gjithmonë e më tepër po bazohen në markuesit biokimik për diagnostikimin e hershëm, diagnozën dhe prognozën. Saktësia e rezultateve laboratorike është një komponent gjithmonë e më i rëndësishëm për kujdesin ndaj pacientit.

Në laborator, intervali midis marrjes së mostrës biologjike nga pacienti deri në dhënien e rezultatit të mjeku, ndahet në 3 faza:

- **Faza preanalitike** përfshin marrjen e materialit dhe përgatitjen për analizë; dmth gjëndjen e pacientit, marrjen e mostrës, transportimin në laborator, përpunimin e materialit dhe kalimin e materialit në instrumentin analizues.
- **Faza analitike** përfshin gjithë hapat e ndërmarra gjatë analizimit të mostrës.
- **Faza post-analitike** përfshin rishikimin e rezultateve për ndonjë anomali të mundshme, raportimin e tyre tek klinikisti dhe ruajtjen e materialit.

Historikisht laboratorët klinikë janë fokusuar në fazën analitike kur monitorojnë cilësinë e rezultateve. Kjo ka përfshirë monitorimin e testeve dhe karakteristikave të tjera, duke përdorur analizën statistikore për vlerësimin e cilësisë. Megjithatë mendohet se 60% e gabimeve laboratorike ndodhin gjatë fazës preanalitike, kështu që ia vlen të përmenden burimet më të zakonshme të këtyre gabimeve.

Proçedura e marrjes dhe transportimit të mostrave biologjike

Një nga fazat më të rëndësishme ku duhet treguar një kujdes i veçantë gjatë praktikës laboratorike, është faza preanalitike. Në këtë fazë ndodhin dhe gabimet në pjesën më të madhe të rasteve në praktikën laboratorike . Prandaj për të parandaluar këtë fenomen duhen ndjekur disa hapa:

- Paisja e labororit me sistem informatizues laboratorik (LIS) për të shmangur ngatërrimin e mostrave biologjike të pacientëve të ndryshëm.
- Përdorimi i tubave dhe kontenerëve të përshtatshëm në varësi të specifikave të mostrës që do të merret për ekzaminimin dhe testin laboratorik që do të kryhet.
- Sigurimi i një transporti të shpejtë dhe me kushte të përshtatshme (temperature) i mostrës biologjike nga vendi i marrjes deri në laborator.
- Përpunimi i saktë i mostrave biologjike në laborator, në mënyrë që të bëhen gati për t'iu nënshtruar proçedurave specifike për testet e ndryshme laboratorike. Ndërsa ato që nuk do të ekzaminohen menjëhere ruhen në temperaturë 2-8 gradë për disa ditë ose për një periudhë të gjatë kohe në gjëndje të ngrirë . Mostra biologjike që ngrihet përdoret vetëm një herë pas proçesit të shkrirjes.

Testet laboratorike ku si mostër biologjike përdoret gjaku

Shumë faktorë të lidhur me gjendjen e pacientit mund të ndikojnë në cilësinë e rezultatit. Në disa sëmundje, substanca të caktuara në trupin e pacientit mund të interferojnë me proçesin e analizës; shembull i tillë është rritja e nivelit të bilirubinës. Gjithashtu pacienti mund të jetë duke marrë medikamente që interferojnë me analizën. Pacienti mund të ketë antitrupa në qarkullim (heterofile, autoimune etj) që mund të interferojnë me vlerësimet. Laboratori nuk mund t'i kontrollojë plotësisht këto burime gabimesh, por duhet t'i ketë parasysh dhe t'i konsiderojë sa herë që rezultati nuk duket i drejtë.

Megjithatë shumica e gabimeve preanalitike lidhen me cilësinë e mostrës. Hemoliza është burimi më i zakonshëm i gabimit. Shkaqe të tjera janë sasia e pamjaftueshme e mostrës, keqetiketimi i tubit, koagulimi i materialit për ekzaminim. Për këtë i duhet dhënë rëndësi procedurave specifike të marrjes së materialit për ekzaminim, pasi çdo hap në përgatitjen e mostrës është esencial. Teknika e gabuar mund të çojë në koagulim të materialit dhe interferencën e fibrinës ose në hemolizë. Për këtë laboratorët duhet të ndjekin udhëzimet e prodhuesit të tubave të marrjes së gjakut.

Interferenca e fibrinës

Fibrina residuale, e cila njihet prej kohësh si interferues laboratorik mund të shkaktohet nga trajtimi i gabuar i mostrës përpara dhe pas marrjes së saj. Mund të paraqitet si koagulim i dukshëm në tubat e analizave, i cili mund ta bllokojë sondën ose mund të paraqitet në formën e mikrofibrave të padukshme, duke ndikuar kështu në rezultatet e testeve laboratorike, veçanërisht ato immune. Në ndryshim nga interferenca e antitropave heterofile ose faktorit reumatoid, interferenca e fibrinës zakonisht nuk është persistente dhe zhduket me kohën, ndërkohe që fibrina largohet nga mostra. Në mënyrë që të evitohet formimi i fibrinës, duhet të merret parasysh prania e sëmundjeve ose mjekimeve që ndikojnë në kohën e koagulimit, përdorimi i tubit të duhur, ruajtja e rradhës kur përdoren shumë tuba, përzjerja e tubit, koha që duhet për koagulim, centrifugimi, transportimi në instrumentin analizues.

Njohja e faktorëve që ndikojnë në koagulim

Sëmundje ose terapi të caktuara mund të ndikojnë në koagulimin e mostrës. Kështu psh gratë shtatzëna dhe pacientët nën dializë shpesh kanë kohë të zgjatur të koagulimit. Shumë pacientë për arsye të ndryshme mjekohen me antikoagulantë të cilët pengojnë koagulimin. Kështu që personeli i laboratorit është mirë që të jetë në dijeni të këtyre sëmundjeve ose terapive. Nëse aftësia e gjakut të pacientit për tu koagulluar është e penguar, atëherë edhe gjaku duhet trajtuar në mënyrë të posaçme: ose duhet për plazmë (në këtë mënyrë nuk është e nevojshme formimi i koagulit) ose duhet lejuar kohë më e gjatë për përgatitjen e mostrës në mënyrë që të formohet koaguli. Nëse këto hapa nuk ndërmerren mund të formohen fije të fibrinës që kompromentojnë rezultatin.



Mbledhja e materialit

Kjo është një pikë shumë e rëndësishme, dhe mund të ndikojë në mënyre madhore në rezultat. Problem i cili mund të rezultojë në një situatë kritike është kur mostra merret me rrugë të tjera përveç asaj venoze.

Përdorimi i një kateteri intravenoz ose shiringe për marrjen e gjakut dhe më pas kalimi në tub mund të rezultojë në një incidencë të lartë mostrash të hemolizuara. Këto procedura gjithashtu mund të ndikojnë në shkallën e formimit të koagulit.

Në rastin e përdorimit të shumë tubave gjatë një flebotomie të vetme, rradha e marrjes duhet realizuar siç përcaktohet në etiketën e tubit; pajisja e shpimit të tubit mund të kontaminohet me aditiv nga tubi i mëparshëm. Tubat e serumit pa aditiv duhen përdorur të parët dhe më pas ata me aktivizues koagulimi. Tubat e plazmës duhen marrë pas atyre të serumit, sepse sasi të vogla heparine ose EDTA që kontaminojnë tubin e serumit mund të ngadalësojnë koagulimin.

Është e rëndësishme të miksohen tubat pas marrjes. Shumica e tubave përmbajnë aditiv që duhen shpërndarë në të gjithë tubin që të jenë efektive. Gjaku i marrë në tuba që përmbajnë heparinë mund të fillojë të formojë mikro-koagula, pasi përqëndrimi i antikoagulantit mund të jetë i ulët në disa zona të tubit përpara përzjerjes. Tubat e serumit sot janë plastike dhe jo xhami dhe përmbajnë aditiv për të nxitur koagulimin. Nëse këta tuba nuk përzien mirë, formimi i koagulit nuk do të nisë në mënyrën e duhur dhe do të duhet më shumë kohë për tu kryer.

Përpunimi i mostrës

Tubat e serumit mund të mos kenë në dispozicion kohën e nevojshme për formimin e koagulit përpara centrifugimit. BD (Becton, Dickinson and Company) rekomandojnë një kohë koagulimi 60 minuta për tubat e serumit dhe 30 minuta për tubat me barriera xhel. Laboratorët nën presion shpesh e shkurtojnë këtë kohë. Kjo rrit probabilitetin e formimit të fibrinës, pas centrifugimit dhe ndarjes, veçanërisht nëse mostra koagulon ngadalë në rastet kur pacienti është shtatzëne ose nën antikoagulantë.

Centrifugimi adekuat është i domosdoshëm për të mundësuar largimin e koagulave ose fibrinës. Në mënyrë që tubat primare të funksionojnë sa më mirë me sondat e mostrave në instrumentet e automatizuar, shtresa e sipërme e barrierës së xhelit duhet të jetë horizontale. Përdorimi i një rotor centrifuge me kënd fiks, dhe koaguli që formohet nga ky ose barriera e xhelit mund të rezultojnë në fije fibrine, kur tubi hiqet nga centrifuga dhe vendoset në pozicion drejt. Po ashtu gabime mund të ndodhin kur volumi i serumit është i pamjaftueshëm.

Së fundmi kujdes duhet treguar gjatë transportimit të materialit. Nëse materialet do të transportohen larg, centrifugimi në laborator është praktikë e mirë, në mënyrë që të evitohet formimi i fijeve të fibrinës. Një alternativë ndaj centrifugimit është përdorimi i filtrave ndarës

që mund të inserohen në tubin primar ose sekondar, për të kapur fijet e fibrinës dhe për ti precipituar ato në fund të tubit. Ndonëse formimi i fibrinës nuk mund të shmanget kurrë nga tubat primare, gjithmonë duhet pasur kujdes për shmangien e gabimeve, në mënyrë që të evitohet përsëritja e testit ose rimarrja e gjakut nga pacienti, duke ulur kështu koston dhe duke përmirësuar kujdesin ndaj pacientit.

Gjaku në varësi të llojit të testeve laboratorike që do të kryhen merret në tuba plastike (vakumi) që përmajnë substanca apo reagentë të ndryshëm (xhel, sfera qelqi, EDTA, citrate natriumi, heparinat natriumi) etj.

Teste biokimike – tuba vakumi SST me xhel ose sfera qelqi. (teste biokimike rutinë, elektrolitë, hormone, markues tumoralë etj). Përrjashtim bëjnë disa teste specifike (amonemia, immunosupresorët, hemoglobina e glikozuar etj.)

Teste hematologjike – tuba vakumi me EDTA (hemograma, ekzaminimet hematologjike formulë leukocitare, eritrocitet, trombocitet, retikulocitet, grupi i gjakut) etj.

Teste të koagulimit – tuba vakumi me citrat natriumi (për të gjithë faktorët e koagulimit) këta tuba nuk përdoren asnjëherë për elektrolitet pasi kanë reagentë me përmajtje natriumi ose kaliumi. Pra mund të japin një rezultat falls të lartë për këto elektrolitë.

Hemokultura – shishe me terrene të gatshme në të cilat injektohet gjaku i pacientit dhe përdoren për identifikimin e mikroorganizmave në gjak, shkaktarë të një infeksioni tek pacienti.

Gjaku për analiza fotosensitive

Disa teste laboratorike si Vit A, Vit B6, beta-karoteni, porfirinat, Vit D dhe bilirubinatin janë të ndjeshme ndaj çfarëdolloj drite (artificiale ose diell). Prandaj kur merret gjaku për këto teste laboratorike duhet të shmanget ekspozimi në dritë të mostrës së gjakut. Këto mostra kanë nevojë për mbështjellje me letër alumini . Gjaku për Vit A, Vit B6, beta-karotene, porfirinat, Vit D dhe bilirubinë janë shembuj të substancave që kanë nevojë për mbrojtje nga drita.

Analiza rutinë e urinës

Mostra duhet marrë nga porcioni i mesëm i çurgut të urinës., gjithmonë pas tualetit të sistemit të jashtëm urinar.

Kontenieri i preferuar për transport është një tub ose gotë plastike sterile me kapak me vidhosje, që të ruhen elementët e figuruar (kristalet, qelizat ose cilindrat hialine dhe granulare) dhe parandalon alterimin e treguesve biokimikë të shkaktuar nga kontaminimi bakterial i urinës. Hidhet urina në tub ose në gotë, mbyllet në mënyrë të sigurtë, shkruhet në anën e jashtme të kutisë emri mbiemri, moshë e pacientit, ora dhe data e mbledhjes. Transportohet në laborator.

Urokultura

Përdoret i njëjti contenier si dhe për analizën rutinë të urinës por që përmban një substancë e cila parandalon rritjen e shpejtë të bakterieve në urinë. Mostra duhet marrë nga porcioni i mesëm i çurgut të urines, gjithmonë pas tualetit të sistemit të jashtëm urinar. Hidhet mostra e urinës në tub ose contenier dhe mbyllet në mënyrë të sigurt. Transportohet në laborator.

Analiza e urinës për kalcium, magnez dhe oxalate

Përdoren contenierë të tipit acid-washed për mbledhjen dhe transportimin e mostrës. Nëse PH i urinës është >4 , rezultatet mund të jenë të pasakta. Mos e mblidhni urinën në contenierë me bazë metali .

Feçet

Përdoret një kontenier special 1000 ml, si psh Nalgenë, për mbledhjen e të gjithë mostrës dhe një kontenier të bardhë polipropileni, 100 ml, për një porcion të vogël të mostrës së feçeve (aliquot). Çdo kontenier duhet të ketë etiketë përpara se t'i jepet pacientit. Pasi kontenieri t'i jepet pacientit, ai instruktohet si më poshtë:

Testet të cilat do t'i bëhen, kërkesat e mostrës, kërkesat dietike, marrja dhe depozitimi i mostrës. Dy kontenierë Nalgenë, prej 1000 ml për mbledhje të planifikuar dhe një kontenier 100 ml për mostrën random.

I jepet informacion se si të përdorë kontenierë të tjerë nëse është e nevojshme dhe të mos mbushë asnjë kontenier më shumë se 3/4 (sipas shenjës në kontenier). Në momentin që pacienti e kthen kontenierin në klinikë, infermieri përgjegjës plotëson etiketën. Nëse është dërguar më shumë se një kontenier, sigurohuni që të jetë shënuar numri total i tyre.

Feçe të homogjenizuara

Për një mostër të homogjenizuar, mostra është 80 ml porcion i feçeve të homogjenizuara. Homogjenizohet dhe peshohet sipas protokollit të laboratorit. Vendoset homogjenizati menjëherë në kontenier. Në etiketë shënohet pesha totale e mostrës së feçeve dhe ujit të shtuar. Gjithashtu shënohet edhe kohëzgjatja e periudhës së mbledhjes. Transportohet mostra në vlerat e lejuara të temperaturës sipas protokollit të laboratorit. Ky test zakonisht bëhet në laboratorë të specializuar reference.

Substancat infeksioze

Në të gjitha mostrat të cilat do të transportohen duhet vendosur etiketa për shkallën e rrezikut. Lëngjet e trupit janë njohur nga CDCP (Center for Disease Control and Prevention) se lidhen direkt me transmetimin e HIV dhe HBV. Prekacionet standarde lidhen me



manipulimin e këtyre mostrave që përfshijnë gjakun, spermën, produktet e gjakut, sekrecionet vaginale, likidin cerebrospinal, lëngun sinovial, likidin pleural, likidin peritoneal, likidin perikardial, likidin amniotik që mund të jenë të infektuara me HIV , HCV dhe HBV. Po ashtu një etiketë rrezikshmërie i duhet vendosur mostrave mikrobiologjike, duke përfshirë bakteret aerobe dhe anaerobe, mykobakteret , kërpudhat etj. Materiali i mbledhur duhet dërguar në tub agari, në një kontenier special dhe jo në pjatat e kulturës.

Etiketohet në mënyrë të qartë çdo mostër me emrin e pacientit, seksin, moshën, numrin e identifikimit, kohën dhe datën e mbledhjes së mostrës, emrin e mjekut që e kërkon dhe emrin e personit që e mori mostrën.

Nëse parashikohet një periudhë kohore prej më shumë se 4 ditë për ekzaminimin e mostrës, atëherë ajo duhet ngrirë. Mostra duhet vendosur në shishe plastike (jo qelqi); konteneri nuk duhet mbushur më shumë se $\frac{3}{4}$, në mënyrë që të mundësohet ekspandimi nëse ngrin. Ruhet në ngrirje ose në akull të ngrirë derisa të çohet për ekzaminim. Etiketohet konteneri me emrin e pacientit, datën dhe tipin e mostrës (psh EDTA, plazëm, serum, urinë).

Urina, eksudatet respiratore, feçet (nuk nevojitet teren mikrobiologjik për transportin e tyre) duhen vendosur në frigorifer përpara se të transportohen. Mostrat që duhen mbajtur në temperaturë dhome përpara inokulimit në terrenin mikrobiologjik përfshijnë lëngjet spinale dhe lëngjet e tjera të trupit, materialet për izolimin e *Neisseria gonorrhoeae* dhe gjaku për hemokulturë dhe kulturat nga plagët. Vendoset mostra në frigorifer përpara se të transportohet. Gjatë paketimit vendoset konteneri në pjesën e çantës që mbyllet me zinxhir ndërsa ftohësin në xhepin e jashtëm. Nëse përdoret akull i thatë, vendoset në një kontener special dhe më pas në çantë. Kujdes që materiali shock-absorbues të vendoset në pozicion të tillë që të mos lejojë zhvendosjet e konteniervë gjatë avullimit të akullit të thatë. Aspirimi me shiringë është mënyra e preferuar e mbledhjes së materialit për organizma anaerobe, në krahasim me marrjen e tyre me tampon. Sapo merret, materiali duhet mbrojtur nga oksigjeni i ambientit dhe nga tharja, derisa të proçesohet në laborator. Konteneri i transportit për organizma anaerobe përfshin:

a. Shiringë për aspirim — e vlefshme vetëm nëse materiali mund të transportohet pa vonesa. Hiqet mbulesa e shiringës përpara se të transportohet (organizmi do të mbijetojë në materialin e aspiruar).

b. Port-a-cult (tub ose shishe) — tubat përdoren kryesisht për inserim të mostrave të marra me tampon; shishet përdoren për inokulimin e mostrave të lëngshme.

c. Kulturat anaerobe — tubi ose jacket plastike vendoset në një tampon që përmban terren mikrobiologjik transporti ose terren të pre-reduktuar. Sistemi i kulturës anaerobe përfshin gjithashtu një shishe ose dhomëz të ndarë nga një membranë që përmban kimikate të cilat

gjenerojnë CO₂, katalizatorë dhe desikante, për të zhdukur O₂ residual që mund të depërtojë në system. Ampula duhet thyer që të aktivizohet sistemi.

d. Sistem bio-bag ose rezervuari plastik — çantë plastike që përman një sistem gjenerimi CO₂, katalizatorë paladiumi dhe një indikator anaerob. Çanta mbyllet pasi janë inokuluar pjatat dhe sistemi gjenerues i CO₂ është aktivizuar. Avantazhi i këtij sistemi është se pjatat mund të observohen direkt për zhvillimin e hershëm të kolonive.

Pjesa e Përgjithshme

Teste Rutinë

TESTE BOKIMIKE	18
TESTE HEMATOLOGJIKE	20
TESTE HORMONALE	21
TESTE IMUNOLOGJIKE	23
TESTE VIRUSALE	24
TESTE MIKROBIOLOGJIKE	25
TESTE ALERGJIKE	26
DOZIMI I MEDIKAMENTEVE	27
ELEKTROFOREZA	28
TESTE TE KOAGULIMIT	29
TESTE NE URINE	30
TESTE TOKSIKOLOGJIKE	31

Testet rutinë janë testet laboratorike që përdoren në mënyrë frekvente nga mjekët klinikistë për diagnostikimin e patologjive më të shpeshta në organizëm.

Testet biokimike përbëjnë pjesën më të madhe të testeve laboratorike dhe na japin një informacion të detajuar të funksionit të organeve kryesore.

Testet Biokimike

Testi laboratorik

Bilirubinë Totale

Bilirubinë Direkte

Bilirubinë Indirekte

ALT (SGPT)

AST (SGOT)

GGT

Glicemi esëll

Glicemi 2 orë pas buke

Hemoglobina e glukozuar (HbA1c)

Creatinemia

Azotemia

Amilazemia pankreatike

Amilazemia pankreatike në urinë

Amilazemi

Lipaza

Fosfataza alkaline (ALP)

Albumin

SE

CR. Proteina

Proteine në urinë

Ferritine

Sideremia

TIBC (kapaciteti lidhës i hekurit)

Transferine

Lipidogramë

Kolesterolemia

Trigliceridet
LDL kolesterol
HDL kolesterol
VLDL
Kreatinë fosfokinaza (CPK)
Kreatinë fosfokinaza membranore (CKMB)
LDH
Mioglobinë
Troponinë
Pro BNP
Faktori reumatoid
Amoniemia
ASO (antistreptolizin)
Elektrolitet në gjak
Calcemi (Ca në gjak)
Kalemi (K në gjak)
Natremit (Na në gjak)
Kloremit (Cl në gjak)
Magnazemi (Mg në gjak)
Fosforemit (P në gjak)
CO2
Uricemi (Acid Urik)

Na japin një informacion (mjekut dhe pacientit) për ekzistencën ose jo të anemisë dhe nëse kjo anemi është e lindur ose e fituar (patologji e rruazave të kuqe të gjakut). Gjithashtu këto teste na japin informacion dhe për ekzistencën ose jo të leukozave (patologji e rruazave të bardha të gjakut).

Testet hematologjike

Testi laboratorik

Gjak komplet

Eritrosedimenti

Ekzaminimi Hematologjik

Eozinofile në lamë

Trombocyte në lamë

Formula leukocitare

Eritrocite në lamë

Testet hormonale

Testi laboratorik

TSH

FT3

FT4

Anti TPO

Anti Tg

Total T3

Total T4

Tiroglobulin (Tg)

Kalcitonina

PTH

FSH

LH

Estradiol

Progesteron

17-hidroxiprogesteroni

Prolaktine

Free Estriol

Free Testosteron

Testosteron

Beta HCG

Kortizol Paradite (8-10 a.m)

Kortizol Pasdite (2-7 p.m)

Kortizoli i lirë urinar

11-deoxikortikosteroni

11-deoxikortizoli

17-hidroxi-kortikosteroidet në urinë

Janë informacioni kryesor për mjekun endokrinolog për vënien e diagnozës së patologjive endokrinologjike. Këto teste shërbejnë për diagnostikimin__ dhe monitorimin e këtyre patologjive.

17-OH-kortikosteroidet

17-ketosteroidet në urinë

IGF-1

GH

ACTH

ADH

Aldosteron pozicion shtrirë

Aldosteron 2 orë post -effort

Aldosteroni në urinë

C Peptidi

Glukagoni

Insulinemia

Acid Folik

Acid Folik eritrocitar

Vitamina B12

2,3 Difosfoglicerati-2,3 DPG

1.25 dihidroxyvitamina D3

25-Hidroxyvitamina D3

Vitamina D3

DHEAS

CO2

Uricemi (Acid Urik)

Testet imunologjike

Testi laboratorik

Grup gjaku revers

Rhezus & Subgrup

Aglutininim i ftohtë

Ig-C3

Komplementi C3

Komplementi C4

Grup gjaku + Rh faktor

Crossmatch (dhuruesi i gjakut)

LISS-COOBS

ANA (Anticorp antinuclear)

IgA

IgG

IgM

Grupi i gjakut

Informimi mbi grupin e gjakut për çdo person është tepër i rëndësishëm dhe shërben si një kartë identiteti mjekësore. Rëndësia e këtij informacioni qëndron në faktin se në çdo intervent kirurgjikal apo në rast aksidenti, grupi i gjakut është informacioni i parë që i duhet mjekut për dhënien e gjakut nëse ai është i domosdoshëm.

Markerat hepaticë (HBV, HCV)

Përqindja e personave mbartës të hepatitit B po vjen gjithmonë duke u rritur (30-35%). Hepatiti C është në vlera më të ulëta mbartshmërie por edhe këto të fundit kanë qënë në rritje. Dëmtimi i mëlçisë që japin këto markera hepaticë është i madh. Ky dëmtim çon deri në cirozë ose karcinomë hepaticë.

Testet virusale

Testi laboratorik

HBSAgultra

HBS Totalquick

HBe Ag

Anti HBe

HBcIgM

HBc total

HAV IgM

Anti-HAV Total

HIV Duo

ANTI- HCV

Ab sifiliz TOTAL

Ab Sifiliz IgM

CMV IgG

CMV IgM

Tokso IgG

Tokso IgM

Rubella IgG

Rubella IgM

HSV 1&2 IgG

HSV 1&2 IgM

EBV-VCA IgM

EBV-VCA IgG

Rota-AdenoVirus

EBNA IgG

Testet mikrobiologjike

Testi laboratorik

Kulturë për gram (+) ose gram (-) vitek 2

Kulturë për gram (+) ose gram (-) manual

Kulturë për myk vitek 2

Kulturë për myk manual

Hemokulturë

Mononukleozë IgM

Streptokok test

Clamidia test

Gjak Bruceleze

Mycoplasma hominis+uroplasma uraliticum

Feçe gjak okult

Feçe parazit

Helikobakter pilori

Strisho vaginale

Ngjyrosje me gram

Me anë të testeve mikrobiologjike bëhet i mundur përcaktimi i shkaktarit infeksioz. Përcaktohet gjithashtu dhe terapia medikamentoze kundër këtij infeksioni.

Patologjitë alergjike shfaqen te njerëzit me shenja të tilla si lotim, rrafë, probleme të fytit. Këto fenomene ndodhin kur ato shkaktohen nga agjentë të mjedisit të jashtëm ose të ambienteve te mbyllura (pluhurat e shtëpisë, pjalmi i luleve etj). Këto patologji mund të shfaqen edhe me probleme në lëkurë (fenomene kutane). Kjo ndodh kur lëkura bie në kontakt me ndonjë substancë kimike ose nga ndonjë medikament që mund të ketë marrë pacienti.

Testet alergjike

Testi laboratorik

IgE

Dermatophagoides Pteronyssinus (D1)

Dermatophagoides Farinae

Cat Epitethelium

Dog Epitethelium

Egg White

Wheat

Cows Milk

Cockroach

Cocksfoot Pollen

Pneumoalergenit (20 agjentë)

Alergentet ushqimore (20 agjentë)

Alergentet pediatrike (20 agjentë)

Sekrecione për eozinofili

Dozimi i medikamenteve

Testi laboratorik

Carbamazepine (Tegretol)

Depakine

Digoksine

Digitoksine

Ciklosporine esëll

Ciklosporine 2 orë pas med.

Lidokaine

Coradaron

Homocisteine

Fenilalanine

Amytriptiline

Phenitonine

Phenobarbital

Gentamycine

Vankomycine

Amikacine

Phenilciklidina në urinë

Teophyline

Ethosuxamide

Lithium

Imipramine

Clonazepam

Medikamente të ndryshme mund të merren nga pacienti për një kohë të gjatë. Në këto rrethana mjeku duhet të marrë një informacion për dozimin e medikamentit, pra dozimi i medikamentit na tregon nëse medikamenti merret në doza terapeutike apo jo. Nëse është më i ulët se nivelet terapeutike (mjekuese), duhet rritur doza e medikamentit që merret. Nëse është më i lartë (nivele toksike), duhet ulur doza, pasi jep dëmtime të ndryshme në organizëm.

Elektroforeza e proteinës (Proteinograma)

Na jep informacion për nivelet e fraksioneve të proteinave që sintetizohen në mëlçi (albuminë-globulinë). Proteinograma normale tregon një funksion normal të mëlçisë. Rritja e fraksioneve të ndryshme të proteinave tregon për prishje të funksioneve të mëlçisë ose për patologji imunologjike.

Elektroforeza

Testi laboratorik

Elektroforeze Hemoglobine

Elektroforeze Proteine

Testet e koagulimit

Testi laboratorik

D-dimere

Indeksi protrombinës (PT)

APTT

Fibrinogjen

Protein C

Koha e Trombinës

Heparinë

Proteina S

Ag.i fibrinogjenit

Antitrombina III

Koagulimi (aftësia e mpiksjes së gjakut)

Këto teste janë informacioni se sa eficient është zinxhiri i koagulimit. Nëse këto teste janë më të larta se norma, tregojnë për hiperkoagulim. Pra janë risqe për trombe në enë të organeve të ndryshme. Nëse janë më të ulët se norma, janë risk për hemorragji (humbje të sasive të gjakut).

Janë kryesisht teste biokimike. Ashtu si dhe në gjak, monitorimi i tyre, tregon funksionin e organeve kryesore. Zakonisht kryhen në urinën e 24 orëve. Disa nga këto teste kryhen dhe vetëm në një porcion urine. Këto quhen teste në urinë random.

Testet në urinë

Testi laboratorik

Urinë komplet

Elektrolitet në urinë

Calcuri (Ca në urinë)

Natriuri (Na në urinë)

Kloruri (Cl në urinë)

Magnezuri (Mg në urinë)

Kaluri (K në urinë)

Uricuri (Acid Urik në urinë)

Creatinuria

Amilazuri

Creatinuria Random

Amilazuri Random

Glukozeuria e 24 orëve

Proteinuria e 24 orëve

Albuminuria e 24 orëve

Testet toksikologjike

Testi laboratorik

Acidi acetylsalicilik

Acetaminopheni

Barbituratet në urinë

Benzodiazepinat në urinë

Ethanoli

Ethanoli

Amphetaminat në urinë

Kanaboidet (hashash, mariuana)

Cocaina

LSD (extasy)

Opiatet (heroinë, morfinë, kodeinë)

Amfetaminat në urinë

Methadoni

Toksikologjia laboratorike është një nga degët e reja por me rëndësi të veçantë në diagnozën toksikologjike. Gjithashtu rëndësi paraqet dhe monitorimi i drogave në gjak dhe urinë gjatë procesit të detoksikimit. Dozimet toksikologjike të barnave (paracetamol, aspirinë etj) apo alkooleve, ndihmojnë në intervenimin sa më të hershëm.

Pjesa speciale

Teste specifike të patologjive të ndryshme

PANELI METABOLIK DHE ELEKTROLITET	34	57	TESTE LABORATORIKE TE PATOLOGJIVE IMUNITARE
TESTE BIOKIMIKE SPECIFIKE	36	62	ELEKTROFOREZAT & IMUNOELEKTROFOREZAT
PROTEINAT SPECIFIKE	39	64	DOZIMI I ANTIGJENEVE DHE ANTIKORPEVE HEPATIKE
LIPOPROTEINAT DHE FOSFOLIPIDET	41	66	TESTE TE PATOLOGJIVE VIRALE DHE AGJENTEVE TE TJERE INFEKSIOZE
TESTE TE DETAJUARA TE KOAGULIMIT	42	77	TESTE LABORATORIKE SIPAS PATOLOGJIVE DHE PROCEDURAVE MJEKESORE
HEMATOLOGJIA LABORATORIKE	44	93	IGE SPECIFIKE DHE INTOLERANCA USHQIMORE
TESTE LABORATORIKE NE URINE	47	97	CHECK UP SIPAS MOSHES DHE SEKSIT
TESTE LABORATORIKE NE FECE	50	101	TESTET PATOLOGJIKE
TESTE LABORATORIKE TE LIKIDIT CEREBROSPINAL	51	102	GJENETIKA PRENATALE DHE BIOLOGJIA MOLEKULARE
TESTE LABORATORIKE TE LIKIDIT ARTIKULAR	53		
MARKUESIT TUMORALE	55		

Testet specifike janë testet laboratorike që përdoren më rrallë në praktikën laboratorike. Zakonisht përdoren për diagnoza të detajuara.

Panelet metabolike dhe elektrolitet përdoren zakonisht për të parë funksionin renal.

Paneli metabolik dhe elektrolitet

Paneli metabolik

Testi laboratorik	Lloji i materialit
KALCIUMI TOTAL	SERUM
KALCIUMI I JONIZUAR	SERUM
DIOKSIDI I KARBONIT	SERUM
KREATININA	SERUM
AZOTEMIA	SERUM
GLICEMIA RANDOM	SERUM
NATRIUMI (Na në gjak)	SERUM
KALEMIA (K në gjak)	SERUM
KLOREMIA (Cl. në gjak)	SERUM

Paneli i elektroliteve në gjak

Testi laboratorik	Lloji i materialit
KALCIUMI TOTAL	SERUM
NATRIUMI (Na në gjak)	SERUM
KALEMIA (K në gjak)	SERUM
KLOREMIA (Cl. në gjak)	SERUM
MAGNEZEMIA (Mg në gjak)	SERUM

Paneli i elektroliteve në urinën e 24-orëve

Testi laboratorik	Lloji i materialit
KALURIA (K në urinën e 24H.)	URINA 24H.
KLORURIA (Cl. në urinën e 24H.)	URINA 24H.
NATRURIA (Na në urinën 24H.)	URINA 24H.

Enzimata specifike

Dozimi i enzimave specifike në organizëm ka rëndësi diagnostike. Këto enzima mund të mungojnë fare ose të jenë në sasi të pakët në organizëm. Kështu ato krijojnë një hendek në zinxhirin metabolik që marrin pjesë. Ky bllokim që ato shkaktojnë bën që të shfaqen patologji të ndryshme në organizëm.

Teste biokimike specifike

- Enzima specifike
- Acide specifike në gjak dhe urinë
- Aminoacidet dhe përcaktimi sasior i tyre
- Mikroglobulinat
- Immunoglobulinat me rëndësi diagnostike
- Acidet yndyrore të lira

Testi laboratorik

5- NUKLEOTIDAZA (5NU)

A2- ANTIPLAZMINA (A2AP)

A1 ANTITRIPSINA (A1AT)

ALDOLAZA (ALD)

AMILAZA PANKREATIKE NE SERUM (AMSP)

AMILAZA PANKREATIKE NE URINE (AMUP)

AMINOPEPTIDAZA E LEUCINES (LAP)

POLIPEPTIDI PANKREATIK (PP)

HIDROKSIBUTIRAT DEHIDROGJENAZA (HBDH)

IZOSITRATDEHIDROGJENAZA (ICD)

FOSFATAZA ACIDE TOTALE (ACP)

FOSFATAZA ACIDE PROSTATIKE (PAP)

FOSFATAZA ALKALINE KOCKORE (BALP)

GLUKOZE 6 FOSFATDEHIDROGJENZA (G6PDH)
KREATININ KINAZA MUSKULARE (CKMB)
PSEUDOKOLINESTERAZA NE SERUM (SCHE)
ENZIMA KONVERSTUESE E ANGIOTENSINES (ACE)
a-FUKOSIDAZA
a-GLUKOSIDAZA
a-LAKTOSIDAZA
a-N-ACETIL LAKTOZEAMINIDAZA
a-N-ACETIL GLUKOZEAMINIDAZA
a1-GLUKOPROTEINA ACIDE (A1-GP)
a1-MICROGLOBULINA
a1-MICROGLOBULINA
ANTI-DNASE B (ADNB)
ANTI-Jo IgG
ANTI-SMITH IgG (ANTISMIgG)
ANTI-SSA IgG (ANTIRoIgG)
ANTI-SSB IgG (ANTILAIGG)
ANTI-U1RNP IgG (ANTIRNPiGg)
AMINOACIDET PERCAK. SASIOR
AMINOACIDET NE URINE
AMINOACIDET NE SERUM
ABSORBIMI I D-KSILOZES
ACETILGLUKOZAMINO-1FOSFOTRANFERAZA
ACIDE TE LIRA YNDYRORE (FFA)
ACIDE YNDYRORE ME ZINXHIRE TE GJATE
ACIDE YNDYRORE JO TE SATURUAR
ACIDI 5-HIDROXI -INDOL ACETIK (5HIAA)
ACIDI AMINOLEVULINIK (ALA)
ACIDI DELTA AMINOLEVULINIK (D-ALA)
ACIDI HOMOVALINIK (HVA)

ACIDI LAKTIK

ACIDI METILMALONIK

ACIDI OMOVALINIK

ACIDI VANILMANDILIK (VMA)

ACIDI GLUTAMIK DEKARBOXILASE (Anti-GAD)

ACIDI CITRIK

a2-MACROGLOBULINA (A2-M)

MALTAZA ACIDE

Proteinat specifike

Testi laboratorik

A1 – ANTITRIPSINA (A1AT)

A2- MAKROGLOBULINAT (A2M)

ALFA FETO PROTEINA NE LIKIDIN AMNIOTIK

AMINOPEPTIDAZA E LUCINES (LAP)

ANTIGENI I FIBRINOGENIT (FIBR-AG)

AUTOANTIKORPET (IA-2)

ENZIMA KONVERTUESE E ANGIOTENSINES (ACE)

EROTROPOETINA (EPO)

GAMA GLOBULINAT (G-GLOBULINAT)

GLOBULINA TOTALE

HAPTOSFERINAT

HOMOCISTEINA (tHcy)

IMUNOGLOBULINA A (IgA)

IMUNOGLOBULINA D (IgD)

IMUNOGLOBULINA E (IgE)

IMUNOGLOBULINA G (IgG)

IMUNOGLOBULINA G (NENKLASAT E IgG) IgG1, IgG2, IgG3, IgG4

IMUNOGLOBULINA M (IgM)

INHIBITORI AKTIV I PLASMINOGJENIT (PAI-1)

INHIBITORI I C1 – ESTERAZES (C1INH)

KRIOFIBRINOGENI NE PLAZEM (CRYO-FIBR)

MIOGLOBINA NE SERUM (MYO)

MIOGLOBINA NE URINE (MYO)

PEPTIDI ANP (ANP)

PEPTIDI I PROKOLAGENIT NE SERUM TIPI I (PICP)

POLIPEPTIDI ENTERIK VAZO AKTIV (VIP)

POLIPEPTIDI PANKREATIK (PP)

PROALBUMINAT

PRODUKTET E FIBRINOLIZES (FDP)

PROTEINA BENCE-JONES

RECEPTORET E SIDEROFILINES

SIDEROFILINA (TRANSFERINA)

TELOPEPTIDI TIPI I i KOLAGENIT C-TERMINAL NE URINE (CROSS LAPS)

TELOPEPTIDI TIPI I i KOLAGENIT N- TERMINAL NE SERUM (NTX)

TELOPEPTIDI TIPI I i KOLAGENIT N- TERMINAL NE URINE (NTX)

TELOPEPTIDI TIPI I i KOLAGENIT C- TERMINAL NE SERUM (ICTP)

ZINXHIRET E LEHTE LAMBDA NE SERUM(LIGHT LAMBDA CHAINS SERUM)

ZINXHIRET E LEHTE LAMBDA NE URINE (LIGHT LAMBDA CHAINS URINE)

ZINXHIRET E LEHTE KAPPA NE SERUM (LIGHT KAPPA CHAINS SERUM)

ZINXHIRET E LEHTE KAPPA NE URINE (LIGHT KAPPA CHAINS URINE)

ZINXHIRET E LIRE KAPPA NE SERUM (FREE KAPPA CHAINS SERUM)

Lipoproteinat dhe fosfolipidet

Testi laboratorik

APOLIPOPROTEINA A1 (APO A1)

APOLIPOPROTEINA A2 (APOA2)

APOLIPOPROTEINA B (APOB)

APOLIPOPROTEINA B-100 (APO B100)

APOLIPOPROTEINA C (APO C)

APOLIPOPROTEINA E (APO E)

FOSFOLIPIDET

FOSFOLIPIDET

FOSFOLIPIDET LDL

FOSFOLIPIDET VLDL

LIPOPROTEINA a (Lpa)

LIPIDET TOTALE

INDEKSI ATEROMATOZ

Inhibitorët e koagulimit

Vendosja e një ekuilibri të mirë midis faktorëve të koagulimit & inhibitorëve të tij ruan gjëndjen normale në organizëm. Rritja e inhibitorëve të koagulimit e frenon koagulimin dhe bëhet risk për hemorragji.

Teste të detajuara të koagulimit

Testi laboratorik

A1 –Antitripsine A1AT

A2-Makroglobulinë

Antigeni i antitrombinës III Aktiviteti i ATIII

Antigeni i fibrinogjenit Ag-FB

Antikorpi antitrombocitar IgA

Antikorpi antitrombocitar IgG

Antikorpi antitrombocitar IgM

Antikoagulaza e Lupusit PTT-LA

Antitrombina III AT III

D-dimere

Faktori II (N.Protrombinës) PT-INR

Faktori V-Leiden

Faktori VIII

Faktori Von Willebrand

Fibrinogjeni

Fibronektina

Inhibitori aktiv i pazminogjenit PAI-1

Inhibitorii C1-esterazës C1INH

Koha e aktivizimit të pjesshëm të tromboplastinës APTT

Koha e Protrombinës PT koha QUICK

Koha e rikalcifikimit të plazmës koha HOWELL

Koha e tromboplastinës parciale PTT

Koha RUSSELL dRWVT

Produktet e zërthimit të fibrinës Fibrinoliza

Proteina C

Proteina S

Proteina S e lire

Pseudocholinesterasa SCHE

Trombocitet në lamë

Trombofaksi

Elektroforeza e hemoglobinës është një nga testet laboratorike më të rëndësishme për të përjashtuar një hemoglobinopati.

Hemoglobinopatia shkaktohet nga hemoglobina defektoze (Hbs; HBS; HbA2.3.5) që shkakton eritrocite të vogla (mikrocite). Ky defekt i hemoglobinës është i lindur. Këto hemoglobinopati quhen anemi të lindura. Elektroforeza e Hb diferencon një anemi të lindur nga një e fituar. Aplikimi rekomandohet mbas moshës 2 vjeç.

Hematologjia laboratorike

Teste imunologjike

Testi laboratorik

Coombs direct DAT

Coombs indirect IDAT

WRIGHT sipas coombs

Imunofenotipiimi i limfociteve B&T me CD për leukozat

Imunofenotipiimi i limfociteve CD3, CD4, CD8

Hemoglobina dhe pigmente të tjera

Testi laboratorik

Hemoglobina Hb.

Hemoglobina A2 Hb.A2

Hemoglobina F Hb.F

Hemoglobina në feçe

Hemoglobina në plazëm

Hemoglobina në serum

Hemoglobina në urinë

Hemoglobina S Hb.S

Methemoglobina

Bart's Hemoglobina

Eritropoetina EPO

Mioglobina

Enzimata eritocitare dhe leukocitare

Testi laboratorik

Fosfataza alkaline leukocitare

Piruvat kinaza eritocitare

Pseudocholinesteraza eritocitare CHE-RBC

Pseudocholinesteraza në serum

2,3 Difosfoglicerati 2,3 -DPG

Glukozë – 6 – fosfatdehidrogenaza G-6-PDH

Vitamina dhe elementë që marrin pjesë në eritropoezë

Testi laboratorik

Vitamina B1 - Thiamina

Vitamina B12 - Kobalamina

Vitamina B12 e pasaturuar - UBBC

Acidi folik eritocitar

Acidi folik në serum

Eritropoetina EPO

Ferritina (Fe depo)

Sideremia (Fe i lirë)

Hekuri në urinë

Kapaciteti lidhës i hekurit TIBC

Receptorët e transferinës

Transferina (siderofilina) TRF

Transferina (siderofilina) e saturuar

Teste të tjera hematologjike

Testi laboratorik

Elektroforeza e hemoglobinës

Ekzaminimi hematologjik

Trombocyte në lamë

Eritrocite në lamë

Leukocyte në lamë

Retikulocyte në lamë

Trupëzat e hemoglobinës Tr.heiNZ

Prova e hemolizës acide Ham-Test

Hemograma-Gjak komplet

Testet laboratorike në urinë

- Acide në urinën 24 orëshe
- Proteina në urinën 24 orëshe
- Hormone në urinën 24 orëshe
- Aminoacide në urinën 24 orëshe
- Elektrolitet në urinën 24 orëshe

Testi laboratorik

ACIDI CITRIK NE URINE

ACIDI URIK NE URINE

B2 MIKROGLOBULINA URINARE

BILIRUBINA URINARE

FRUKTOZURIA

GLUKOZURIA

HEMOGLOBINURIA

KETONURIA

PROTEINURIA NE URINEN 24-ORESHE

PROTEINA BENCE-JONES NE URINE

PROTEINA BENCE-JONES NE URINE ME ELEKTROFOREZE

EROFOREZA E PR.URINARE (ELEKTROFOREZA E PROTEINAVE URINARE)

IMUNOETROFOREZA E PR. URINARE (IMUNOELEKTROFOREZA E PROTEINAVE URINARE)

ESTRONI (E1) NE URINEN 24 ORESHE
ESTRIOLI (E3) NE URINEN 24-ORESHE
ESTRADIOLI (E2) NE URINEN 24-ORESHE
17-OH-KORTIKOSTEROIDET NE URINE (17-OH-CS)
ABSORBIMI I D-KSILOZES NE URINE
ACIDI 5-OH-INDOLACETIK (5-HIAA)
ACIDI AMINOLEVULINIK-DELTA (ALA)
ACIDI METILMALONIK
ACIDI OMOVALINIK (HVA)
ACIDI VANILMANDILIK (VMA, Kateolaminat në urinën 24H)
ADRENALINA URINARE
AMINOACIDET NE URINE (tirozine, fenilalanine)
AZOTI URINAR
BAKRI NE URINEN 24H.
FOSFORI NE URINEN E 24H.
KALCIUMI NE URINEN E 24H.
KROMI NE URINEN E 24H.
MAGNEZI NE URINEN E 24H.
NATRIUMI NE URINEN E 24H.
PLUMBI NE URINEN E 24H.
SELENIUMI NE URINEN E 24H.
ZINKU NE URINEN E 24H.
HEKURI NE URINEN E 24H.
KLORI NE URINEN E 24H.
CISTINA URINARE
DOPAMINA URINARE
FENILALANIA URINARE
FENILKETONURIA
HIDROXIPROLINA URINARE
LIZOZIMA URINARE
MELANINA URINARE

METANEFIRINAT URINARE

MIOGLOBINA URINARE

C-PEPTIDI URINAR

PREGNANDIOLI NE URINE

PROGESTERONI NE URINE

NORADRENALINA URINARE

OXALATET URINARE

PORFIRINAT TOTALE

PORFIRINOGENI

SEROTONINA URINARE

TELOPEPTIDI C CTX,a-crossLaps

TELOPEPTIDI N NTX

UROBILINOGENI URINAR

A1-MIKROLOBULINA URINARE

KOPROPORFIRINAT

UROPORFIRINAT

Ekzaminimet në fece bëhen zakonisht në fëmijë në raste gastroenteritësh. Parazitizat janë shumë të shpeshta tek fëmijët. Kjo vërehet sidomos në fëmijët që bëjnë jetë në komunitet (kopshte, çerdhe)

Testet laboratorike në feçe

Testi laboratorik

FECE GJAK OKULT

KOPROKULTURA MANUALE

KOPROKULTURA AUTOMATIKE

YNDYRNAT NE FECE

FECE PARAZIT

LEUKOCITET NE FECE

FIBRAT ELASTIKE NE FECE

MUKUSI NE FECE

ETROLITETET NE FECE

Testet laboratorike të likidit cerebrospinal

Biokimike

Testi laboratorik

a2-makroglobulina a2-M

Acidi laktik

Acidi urik

Albumina

Glukoza

Azoti

Kaliumi

Natriumi

Klori

Kreatinina

LDH

Lizozima

Proteina totale

Enzima konvertuese e angiotenzimës ACE

Citologjike

Testi laboratorik

Formula leukocitare e LCS

Imunologjike

Testi laboratorik

Imunoelektroforeza

Elektroforeza e proteinave

IgA

IgG

IgM

